



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.07.2024

Nr: 103

Ora: 18:08

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË MC NETWORKING, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR
VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR Kryetar TË Bashkisë Himarë TË DATËS 4 GUSHT
2024

Sot në datën 22.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: MC NETWORKING, me adresë në RRUGA E VILAVE, TEG;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 22.07.2024
Ora: 18:08

Nr: 103



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

V Ë R E J:

MC NETWORKING i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 4 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 19.07.2024.

MC NETWORKING, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 4 vëzhguesve të MC NETWORKING për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 22.07.2024 Nr: 103
Ora: 18:08



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te MC NETWORKING

	Emri	Mbiemri	Mandati	Seriali	Zona e vëzhgimit
1.	ANDON	KELLO	Media	000028	Ne te gjithë vendin
2.	EDI	RUÇI	Media	000029	Ne te gjithë vendin
3.	ROBERT	QIROLLARI	Media	000030	Ne te gjithë vendin
4.	BLEDAR	LUGA	Media	000031	Ne te gjithë vendin

Data: 22.07.2024
Ora: 18:08

Nr: 103



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024